



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 3.12.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Driton Çaushti, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Munguan: Arbërie Nagavci, Fidan Rekaliu, Verica Çeraniq dhe Nezir Çoçaj.

Përfaqësues tjerë: Përfaqësues të MKRS, dhe të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Shaip Goxhuli dhe Lule Ymeri.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.11.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.11.2018

Procesverbali, i mbledhjes së datës 12.11.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë

Ismajl Kurteshi tha se komisioni është në fazën e shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kinematografinë, i cili në mbledhjen e fundit nuk është përfunduar, dhe se dilemat e anëtarëve të komisionit kanë të bëjnë në lidhje me nenin 2 të Projektligjit, që i referohet nenit 55 të Ligji bazik ku shihet se është ulur vlera e gjobës që ndërlidhet me ndryshimin e veprimtarisë së kinemave. Me këtë rast kërkoi sqarim nga përfaqësuesit e ministrisë.

Feim Hoxha, përfaqësues i MKRS, tha se qëllimi i ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit dhe me këtë rast Projektligjit për Kinematografinë ka të bëjë ekskluzivisht me harmonizimin me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje për sa i përket gjobave. Sa i përket dilemave të ngritura rreth uljes së gjobave te neni 55 i ligjit bazik tha se në këtë rast mund të ngritet vlera minimale, por jo maksimale pasi që është vlera maksimale e paraparë sipas Ligjit për kundërvajtje, e që e njëjta mund të dyfishohet nëse ka për qëllim përfitimin nga ndryshimi i veprimtarisë.

Driton Çausi tha se nga takimet me përfaqësues të shoqërisë civile janë paraqitur disa vërejtje lidhur me nenin 2 të projektligjit, që i referohet ndryshimit të nenit 55 të Ligjit bazik, me të cilin parashihet zvogëlimi i gjobës nga 120.000 euro, në 20.000 euro maksimumi, është jo e drejtë sepse gjoba e ulët prej 20.000 euro, siç parashihet në projektligj, mund ta mundësojë ndërrimin e veprimtarisë së kinemave.

Teuta Haxhiu tha se parimisht është për harmonizimin e këtyre projektligjeve me Ligjin për kundërvajtje, ndërsa propozoi që neni 2 i projektligjit që i referohet ndryshimit të nenit 55 të ligjit bazik të rritet pragu minimal nga 2 000 (dy mijë) në 10.000 (dhjetëmijë) euro.

Valentina Bunjaku-Rexhepi tha se është kundër propozimit për uljen e gjobave ngase këtë gjobë mund ta përballojë secili biznes privat, kur kemi parasysh se nga ndërrimi i veprimtarisë mund të përfitojnë shumë më shumë bizneset.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, në lidhje me nenin 2 të Projektligjit, që i referohet nenit 55 të Ligji bazik, kryesuesi hodhi në votim propozimin për rritjen e vlerës minimale nga 2.000 (dy mijë) në 10. 000 (dhjetëmijë) euro.

Për këtë propozim votuan 4 (katër) **për**, ndërsa 3 (tre) ishin **kundër**.

Anëtarët e komisionit vazhduan me shqyrtimin nen për nen të projektligjit, dhe u propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.2004/22 për Kinematografinë.

Amendamenti 2

Neni 2 ndryshohet si vijon:

Neni 2

Neni 55 i ligjit bazik, ndryshohet si vijon:

Neni 55

Me gjobë prej 10.000 (dhjetëmijë) euro deri në 20 000 (njëzetmijë) euro, gjobitet për kundërvajtje distributori, përkatësisht pronari ose qiramarrësi i një kinemaje që e ndryshon qëllimin e veprimtarisë së kinemasë pa pëlqimin e QKK, sipas nenit 8 të këtij Ligji.

Amendamenti 3

Neni 3 ndryshohet si vijon:

Neni 3

Neni 56 i ligjit bazik, ndryshohet si vijon:

Neni 56

1. Me gjobë prej 500 (pesëqind) euro deri në 10.000 (dhjetëmijë) euro gjobitet për kundërvajtje shfaqesi, përkatësisht distributori:

1.1. Që shfaq një film të pa pajisur me lejen për shfaqje publike sipas nenit 9 të këtij ligji ose që i është refuzuar dhënia e lejes sipas nenit 10 paragrafi 2 të këtij Ligji;

1.2. Që lejon të miturave nën 14 vjeç të kenë qasje në kinema kur filmi është i pajisur me lejen e kategorisë “B“, ose të miturve nën 18 vjeç sipas nenit 10, paragrafi 1, pika (b) dhe (c) të këtij Ligji;

1.3. Që shfaqë një film para orës 22,00 me përmbajtje në kuptim të nenit 10 paragrafi 3 të këtij Ligji.

Amendamenti 4

Neni 4 ndryshohet si vijon:

Neni 4

Neni 57 i ligjit bazik ndryshohet si vijon:

Neni 57

Me gjobë prej 200 (dyqind) euro deri në 5.000 (pesëmijë) euro gjobitet për kundërvajtje, producenti që nuk vepron sipas nenit 54, paragrafi 1 të këtij ligji.

Amendamenti 5

Neni 5 ndryshohet si vijon:

Neni 5

Neni 58 i ligjit bazik ndryshohet si vijon:

Neni 58

Me gjobë prej 500 (pesëqind) euro deri në 2.000 (dymijë) euro gjobitet për kundërvajtje anëtari i jurisë vlerësuese që ka fshehur informacionin ose faktin që paraqet pengesë për të qenë anëtar i jurisë vlerësuese ose që ka marrë pjesë në mbledhjen e jurisë vlerësuese përkundër pengesave në nenin 43, paragrafi 6 të këtij ligji.

Anëtarët e komisionit me shumicë votash (4-për dhe 3-kundër) miratuan amendamentet e propozuara dhe raporti me amendamente procedohet në komisionet e përhershme.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Ismajl Kurteshi tha se projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta ka kaluar leximin e parë dhe propozoi që të vazhdohet me shqyrtimin nen për nen.

Anëtarët e komisionit vazhduan me shqyrtimin nen për nen të projektligjit, dhe u propozuan këto amendamente:

Amandamenti 1

Titulli i projektligjit ndryshohet si vijon:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR.05/L-047

Amandamenti 2

Neni 1 ndryshohet si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-047

Amandamenti 3

Neni 3 i projektligjit, paragrafi 1 i nenit 192 i Ligjit bazik ndryshohet si vijon:

1. Me gjobë prej 5.000 (pesëmijë) euro deri 20.000 (njëzetmijë) euro dënohet për kundërvajtje çdo person juridik ose biznes individual:

Nënparagrafët e tjerë mbeten si në projektligj.

Anëtarët e komisionit unanimisht miratuan amendamentet e propozuara dhe raportin me amendamente e procedojnë në komisionet e përhershme.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat

Ismajl Kurteshi tha se projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat ka kaluar leximin e parë dhe propozoi që të vazhdohet me shqyrtimin nen për nen.

Anëtarët e komisionit vazhduan me shqyrtimin nen për nen të projektligjit, dhe u propozuan këto amendamente:

Amantamenti 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-097 për Bibliotekat.

Amantamenti 2

Neni 2 i projektligjit, paragrafi 1 i nenit 25 i Ligjit bazik ndryshohet si vijon:

1. Me gjobë prej 100 (njëqind) euro deri në 2.000 (dymijë) euro dënohet për kundërvajtje përdoruesi që nuk e kthen, e dëmton, tjetërson ose e asgjëson materialin bibliotekar ose në ndonjë mënyrë tjetër shkel rregullat e përdorimit të materialit bibliotekar, ndërsa personi juridik nga 5.000 (pesëqind) euro deri në 20.000 (njëzetmijë) euro.

Paragrafët e tjerë mbeten si në projektligj.

Anëtarët e komisionit unanimisht miratuan amendamentet e propozuara dhe raportin me amendamente e procedojnë në komisionet e përhershme.

6. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi ngriti çështjen si vijon: organizimit të një punëtorie me mbështetje nga GIZ në janar të 2019 për hartimin e planit të punës dhe diskutimit të çështjeve nga fusha e arsimit; mbajtjen e një takimi me përfaqësues të GIZ-it më 5.12.2018; raportimin në Komision të ministrit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë; realizimin e një vizite në Agjencinë e Akreditimit; organizimin e një takimi me rektorët e universiteteve publike dhe shqyrtimin e projektligjit për Arsimin e Lartë i cili është proceduar në Kuvend.

Teuta Haxhiu, ngriti çështjen e kërkesës së mbi 40-të studentëve të programit master Menaxhimi në Arsim në Fakultetin të Edukimit, duhet të kërkohet si është akredituar ky program në Agjenci të Akreditimit dhe sa studentë kanë përfunduar këtë program, po ashtu përmendi edhe çështjen e organizimit të një trajnimi Udhëheqja në arsim, trajnim ky 21 ditor dhe që organizohet nga OJQ, në dokumentet që lëshohen në përfundim të trajnimit nënshkruajnë përfaqësues të GIZ-it, MASHT dhe OJQ-së, trajnimi kushton 250 euro dhe mbahet në institucione publike të cilat nuk përfitojnë asgjë, dhe ky trajnim vlerësohet më shumë se sa programi 2 vjeçar në master me rastin e përzgjedhjes për drejtor dhe zëvendës drejtor.

Ismajl Kurteshi tha se ka takuar përfaqësues të studentëve të Fakultetit të Edukimit dhe kërkesat e tyre përmes një shkrese i ka adresuar te ministri në MASHT dhe që ende nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga ai.

Albulena Balaj- Halimaj ngriti çështjen e kërkesës së Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren për rritjen e buxhetit për plotësimin e normave në arsimin parauniversitar në këtë komunë.

Ismajl Kurteshi, tha se kërkesa e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prizren, e diskutuar më parë në komision është adresuar te ministritë e MASHT, MF dhe MAP.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, tha se ka shumë vërejtje lidhur me kriteret për përzgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit në udhëzimin administrative dhe propozoi që të kërkohet nga MASHT që ta ndryshojë këtë udhëzim administrativ.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që t'i dërgojnë shkresë ministrit të MASHT, me qëllim që të fillojnë procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ për kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi